UDHËZIM
Nr. 2, datë 23.3.2018

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 19.2.2018, "PËR KRITERET, PROCEDURAT DHE MËNYRËN E ADMINISTRIMIT TË FONDIT TË PROGRAMIT PËR BUJQËSINË DHE ZHVILLIMIN RURAL"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 6, pika 3, të ligjit nr. 9817, datë 22.10.2007, "Për bujqësinë dhe zhvillimin rural", të ndryshuar," të nenit 18, të ligjit nr. 64/2012, "Për peshkimin", të VKM-së nr. 701, datë 12.10.2016, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të peshkimit për periudhën 2016-2021", ligjit nr. 109, datë 30.12.2017, "Për buxhetin e vitit 2018"; të pikës 4, të VKM-së nr. 72, datë 7.2.2018, "Për përcaktimin e kritereve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural për vitin 2018", të VKM-së nr. 21, datë 12.1.2018, "Për disa shtesa në vendimin 709, datë 29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale për Zhvillimin Rural dhe Bujqësor 2014-2020", VKM-së nr. 22, datë 12.1.2018, "Për miratimin e kritereve për certifikimin e veprimtarisë së agroturizmit", të udhëzimit të Ministrisë së Financave, nr. 19, datë 3.11.2014, "Për zbatimin e regjimit të veçantë të masës së kompensimit të prodhimeve bujqësore, për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar",

UDHËZOJMË:

Në udhëzimin nr. 1, datë 19.2.2018, "Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të fondit të programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural", bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë vijon:

1. Në kreun IV, paragrafi i dytë, në fund të fjalisë "Aplikimet do të bëhen nga data 28.2.2018 deri më 28.3.2018", shtohet "ndërsa për masat mbështetëse të investimeve me nr. 12, 20-24, 32-36, 40 dhe 44-52, afati i aplikimit do të jetë deri në 27.4.2018".

2. Në kreun VI, pika 2 (i), shkronja "f", në fund të fjalisë: "Të realizojnë mbjelljet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2018", shtohet: "me përjashtim të mbjelljeve të luleshtrydhes në serra dhe/ose tunele, që realizohen edhe në periudhën gusht-tetor".

3. Në kreun IX, pika 2, Masa 45, "i", shkronja "a" dhe "iii", shkronja "c", shfuqizohen.

4. Në aneksin 2, grup-masat III, shtohet "Ambiente grumbullimi dhe ruajtëse frigoriferike për prodhime peshkore (përfshirë dhe akuakulturën), masa 20".

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË
DHE ZHVILLIMIT RURAL
Niko Peleshi
MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Arben Ahmetaj